Duke Mbështetur Qeverisjen e Mirë dhe Qytetarinë Aktive
Supporting Good Governance and Active Citizenry

HULUMTIM MBI PARTITË POLITIKE

“Qëndrimet e Qytetarëve mbi Zgjedhjet dhe Partitë Politike në Kosovë”

Nëntor, 2015

PËRMBAJTJA

1. Metodologjia dhe Mostra 5

2. Preferencat për Partitë Politike 6

2.1. Preferencat sipas Gjinisë, Moshës, Edukimit dhe Regjioneve 8

3. Zgjedhjet e Përgjithshme të Parakohshme 10

3.1. Qëndrimet mbi Subjektet e reja Politike 13

LISTA E FIGURAVE

Figura 1. A mund të na tregoni se për cilën parti politike keni votuar në zgjedhjet e përgjithshme në Kosovë të organizuara në vitin 2014? 6
Figura 2. Nëse pas një jave do të zhvilloheshin zgjedhjet e përgjithshme në Kosovë, cilën nga partitë e listuara më poshtë do ta votonit?..... 7
Figura 3. Nëse pas një jave do të zhvilloheshin zgjedhjet e përgjithshme në Kosovë, cilën nga partitë e listuara më poshtë do ta votonit? [vetëm rezultatet për partitë e deklaruara] 7
Figura 4. Nëse pas një jave do të zhvilloheshin zgjedhjet e përgjithshme në Kosovë, cilën nga partitë e listuara më poshtë do ta votonit? [sipas gjinisë] 8
Figura 5. Nëse pas një jave do të zhvilloheshin zgjedhjet e përgjithshme në Kosovë, cilën nga partitë e listuara më poshtë do ta votonit? [sipas moshës] 9
Figure 6. Nëse pas një jave do të zhvilloheshin zgjedhjet e përgjithshme në Kosovë, cilën nga partitë e listuara më poshtë do ta votonit? [sipas regjioneve] 9
Figura 7. Nëse pas një jave do të zhvilloheshin zgjedhjet e përgjithshme në Kosovë, cilën nga partitë e listuara më poshtë do ta votonit? [sipas nivelit të shkollimit] 10
Figura 8. A besoni se në Kosovë duhet zhvilluar zgjedhje të përgjithshme të parakohshme? . 11
Figura 9. A besoni se në Kosovë duhet zhvilluar zgjedhje të përgjithshme të parakohshme? (analiza e bazuar në elektoratin e partive politike në zgjedhjet e përgjithshme 2014)... **Error! Bookmark not defined.**
Figura 10. Në rast se në zgjedhjet e ardhshme (zgjedhjet për Kuvendin e Kosovës) do të garonte një parti e re politike, a do ta votonit atë? 13
Figura 11. Në rast se në zgjedhjet e ardhshme (zgjedhjet për Kuvendin e Kosovës) do të garonte një parti e re politike, a do ta votonit atë? [sipas gjinisë] 14
Figura 12. Në rast se në zgjedhjet e ardhshme (zgjedhjet për Kuvendin e Kosovës) do të garonte një parti e re politike, a do ta votonit atë? [sipas grup moshave] 14

Akronimet

AAK	Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës
AKR	Aleanca Kosova e Re
KQZ	Komisioni Qëndror i Zgjedhjeve
LDK	Lidhja Demokratike e Kosovës
LS	Lista Serbe
LVV	Lëvizja VETËVENDOSJE
PD	Partia e Drejtësisë
PDK	Partia Demokratike e Kosovës

1. Metodologjia dhe Mostra

Studimi i titulluar "Qëndrimet e qytetarëve mbi zgjedhjet dhe partitë politike në Kosovë" është zhvilluar në 38 komuna të Kosovës duke përdorur metodën sasiore të hulumtimeve. Për përcaktimin e mostrës në këtë hulumtim është përdorur teknika e **"mostrës së shtresuar të rëndomtë"**, me ç 'rast popullata e përgjithshme është ndarë në grupe më të vogla që njihen si shtresa – bazuar në karakteristikat e përbashkëta të pjesëtarëve të këtyre shtresave.

Shtresimi i parë: është bërë në bazë të përkatësisë etnike, ku janë krijuar tri nën-grupe të ndryshme. Shtresimi i dytë: është bërë në bazë të vendbanimeve. Për secilën komunë është bërë shtrirja e mostrës në pjesët urbane dhe rurale sipas statistikave zyrtare të ASK-së. Shtresimi i tretë: është bërë në bazë të numrit të anketave të realizuara në secilin vendbanim (pikë fillestare). Pikat fillestare në këtë hulumtim janë përcaktuar sipas metodës së rastësisë. Hulumtimi është zhvilluar në terren nga data 06 deri më deri më 17 Nëntor 2015. Ky hulumtim ka nivel të besueshmërisë prej 95% me marzhë të gabimit +- 3.1%.

Në kuadër të këtij hulumtimi janë anketuar 1000 qytetarë të Kosovës, të moshës mbi 18 vjeç: shqiptarë (750), serb (150) dhe pjesëtarë të komuniteteve të tjera (100). Mostra më pas është peshuar, për të reflektuar strukturën etnike në Kosovë. Para se të administrohet pyetësori në terren, fillimisht është bërë testimi i pyetësorit për të identifikuar problemet logjike dhe përmbajtjësore si dhe është zhvilluar trajnimi i anketuesve. Përzgjedhja e të anketuarve është bërë përmes këtyre tre fazave:

FAZA E PARË: Përzgjedhja e shtëpisë përmes teknikës së ecjes sistematike të rastit

Në këtë fazë, anketuesi nga pika fillestare ka përzgjedhur çdo të tretën shtëpi në anën e majtë të rrugës. Në rastet kur shtëpia ka qenë e pabanuar ose kur anketuesi është refuzuar, njësia e banimit është kaluar dhe është vazhduar me qasjen sistematike.

FAZA E DYTË: Pyetjet përjashtuese – Identifikimi i kandidatit të përshtatshëm për intervistë

Në këtë fazë, qëllimi është identifikimi dhe kontaktimi i kandidatit të përshtatshëm për intervistë. Për këtë fazë, UBO Consulting ka përzgjedhë anëtarin i cili është i moshës mbi 18 vjeç dhe që ka datëlindjen e ardhshme më të afërme.

FAZA E TRETË: Zhvillimi i intervistave ballë-për-ballë

Para se të fillohet me anketim, anketuesi është siguruar që i anketuari të kuptojë qartë qëllimin e studimit dhe rëndësinë e përgjigjeve të tij përmes anketës. Anketimi është bërë ballë-për-ballë, pa prezencën e anëtarëve tjerë të familjes.

Kontrollimi i cilësisë së anketimit është bërë edhe pas përfundimit të punës në terren përmes

verifikimit (thirrjeve telefonike dhe vizitave) të 30% të anketave të realizuara. Të dhënat e grumbulluara janë përpunuar në programin SPSS, prej edhe nga janë fituar rezultatet e këtij raporti.

2. Preferencat për Partitë Politike

Përmes këtij studimi Lëvizja FOL ka kërkuar nga qytetarët e Kosovës, të deklarojnë votën e tyre të dhënë në zgjedhjet e fundit të përgjithshme në Kosovë (2014). Rezultatet për pyetjen "A mund të na tregoni se për cilën parti politike keni votuar në zgjedhjet e përgjithshme në Kosovë të organizuara në vitin 2014?" janë prezantuar në grafikun e mëposhtëm:



Figura 1. A mund të na tregoni se për cilën parti politike keni votuar në zgjedhjet e përgjithshme në Kosovë të organizuara në vitin 2014?

Duke parë rezultatet e mësipërme dhe duke krahasuar ato me rezultatet e certifikuara nga Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, shohim se dallimi në mes këtyre rezultateve është shumë i vogël. Përveç opinionit të qytetarëve në lidhje me zgjedhjet e përgjithshme të vitit 2014, Lëvizja FOL ka arritur të identifikojë preferencat momentale të qytetarëve mbi partitë politike. Në këtë aspekt, qytetarët e anketuar janë pyetur në këtë mënyrë: "Nëse pas një jave do të zhvilloheshin Zgjedhjet e Përgjithshme në Kosovë, cilën nga partitë politike do ta votonit?". Me këtë rast, nga kjo pyetje kanë dalë këto të dhëna:

Figura 2. Nëse pas një jave do të zhvilloheshin zgjedhjet e përgjithshme në Kosovë, cilën nga partitë e listuara më poshtë do ta votonit?

Para se të analizojmë rezultatin e grafikut të mësipërm, duhet të potencojmë së në këtë pyetje janë përgjigjur rreth 86.8% e të anketuarve përderisa 13.2% kanë deklaruar se nuk do të votonin nëse pas një jave do të zhvilloheshin zgjedhjet e përgjithshme në Kosovë. Bazuar në këtë, kategorinë e qytetarëve të cilët nuk do të votonin e kemi larguar nga kalkulimi. Sidoqoftë ajo që shohim në rezultatin e mësipërm është përqindja e lartë e të anketuarve, të cilët nuk janë deklaruar për asnjë subjekt politik. Në fakt nëse mbledhim përqindjet "nuk jam i/e sigurt", "i/e pavendosur ende", "nuk e di" dhe "refuzon të përgjigjet", atëherë

Figura 3. Nëse pas një jave do të zhvilloheshin zgjedhjet e përgjithshme në Kosovë, cilën nga partitë e listuara më poshtë do ta votonit? [vetëm rezultatet për partitë e deklaruara]

fitojmë shifrën prej 22.3% e të anketuarve të cilët nuk janë të vendosur për kë do të votonin. Nëse analizojmë vetëm përgjigjet e të anketuarve për partitë politike atëherë shohim se PDK prinë me 29.6%, pas saj renditet LDK me 25.3%, LVV me 17.1%, kurse partitë tjera të cilat kanë më pak se 10% të votuesve janë: AAK me 8.8%, NISMA 5.8% dhe krejt në fund LS me 3.1% dhe PD me 1.3%. Këto rezultate tregojnë se edhe pas zgjedhjeve të ardhshme ndërtimi i koalicioneve në mes të subjekteve politike është i pashmangshëm.

2.1. Preferencat sipas Gjinisë, Moshës, Edukimit dhe Regjioneve

Përveç rezultateve të përgjithshme, studimi ka arritur të identifikojë preferencat e të anketuarve për partitë politike bazuar edhe në faktorë të tjerë demografik si: gjinia dhe mosha, si dhe në aspektin gjeografik, atë regjional. Gjithashtu në këtë pjesë të raportit do të paraqiten rezultatet bazuar edhe në aspektin e edukimit të të anketuarve.

Në grafikun e mëposhtëm janë prezantuar preferencat e të anketuarve për partitë politike duke pasur për bazë aspektin gjinor:



Figura 4. Nëse pas një jave do të zhvilloheshin zgjedhjet e përgjithshme në Kosovë, cilën nga partitë e listuara më poshtë do ta votonit? [sipas gjinisë]

Siç shihet nga grafiku i paraqitur më lartë, shumica e partive politike përqindjen e votuesve meshkuj e kanë më të lartë, përjashtuar këtu LVV-në, ku përqindja e femrave është më e lartë për 4.4% në krahasim me meshkujt votues të kësaj partie.

Nëse analizojmë moshën e të anketuarve të deklaruar për partitë politike atëherë vërejmë që votuesit e rinj (18-25) preferojnë PDK-në (21.3%) kurse mosha mbi 65+ janë deklaruar për LDK-në (36.4%).

Në grafikun e mëposhtëm janë paraqitur rezultatet e të anketuarve për preferencat e tyre



Figura 5. Nëse pas një jave do të zhvilloheshin zgjedhjet e përgjithshme në Kosovë, cilën nga partitë e listuara më poshtë do ta votonit? [sipas moshës]

mbi paritë politike të ndara në bazë të shtatë regjioneve të Kosovës.



Figure 6. Nëse pas një jave do të zhvilloheshin zgjedhjet e përgjithshme në Kosovë, cilën nga partitë e listuara më poshtë do ta votonit? [sipas regjioneve]



Figura 7. Nëse pas një jave do të zhvilloheshin zgjedhjet e përgjithshme në Kosovë, cilën nga partitë e listuara më poshtë do ta votonit? [sipas nivelit të shkollimit]

Nëse analizojmë rezultatet atëherë vërejmë se LDK prinë në regjionin e Prishtinës (25.2%) dhe Gjilanit (20.6%), PDK në regjionin e Mitrovicës (23.3%), Prizrenit (34.2%), Gjakovës (19.8%) dhe Ferizajt (29%) kurse AKK në regjionin e Pejës (11.7%). Në anën tjetër, rezultatet kanë treguar se LVV ka një shtrirje pothuajse të njëjtë në të gjitha regjionet e Kosovës, përjashto këtu regjionin e Gjakovës ku përqindja e të anketuarve është me e ulët (6.3%).

Rezultatet tregojnë se pjesa më e madhe e të anketuarve (26.3%) të cilët kanë deklaruar se kanë të përfunduar "shkollën fillore ose më pak" do të votonin PDK-në, LDK favorizohet nga 17.2% e kësaj kategorie kurse LVV nga 16.2%. Nëse analizojmë të anketuarit me nivel më të lartë të edukimit "fakultet" ose "magjistraturë dhe doktoratë" atëherë vërejmë që LDK, prinë në raport me partitë tjera politike.

3. Zgjedhjet e Përgjithshme të Parakohshme

Duke parë situatën e tanishme politike por edhe duke analizuar në kronologji ngjarjet pas certifikimit të rezultateve të zgjedhjeve të përgjithshme në Kosovë, Lëvizja FOL ka qenë e interesuar për të kuptuar qëndrimet e qytetarëve mbi zgjedhjet eventuale të përgjithshme të parakohshme.



Figura 8. A mendoni se në Kosovë duhet zhvilluar zgjedhje të përgjithshme të parakohshme?

Siç shihet nga grafiku i paraqitur më lartë 37% e qytetarëve të anketuar besojnë së në Kosovë duhet zhvilluar zgjedhje të përgjithshme të parakohshme përderisa vetëm 38.4% e të anketuarve nuk besojnë së duhet të ketë zgjedhje të tilla. Pjesa tjetër e të anketuarve janë përgjigjur me "nuk e di" (16.2%), "nuk jam i/e sigurt" (5.9%) dhe "refuzon të përgjigjet" (2.5%).

Për të qenë me e kuptueshme, studimi ka arritur të identifikojë elektoratin e partive që kërkojnë zgjedhje të përgjithshme të parakohshme. Rezultatet e hulumtimit tregojnë së pothuajse të gjithë (95.5%) votuesit e Listës Serbe, besojnë së në Kosovë duhet të ketë zgjedhje të përgjithshme të parakohshme. Pas tyre renditen votuesit e partive opozitare në Kosovë, NISMA (71.7%), LVV (68.9%) dhe AAK (60.9%). Siç shihet nga grafiku i paraqitur më lartë nga ata që kanë besuar se në Kosovë duhet zhvilluar zgjedhje të përgjithshme të

Figura 9. A mendoni se në Kosovë duhet zhvilluar zgjedhje të përgjithshme të parakohshme? (analiza e bazuar në elektoratin e partive politike në zgjedhjet e përgjithshme 2014)

parakohshme, janë edhe votuesit e dy partive në pushtet. Në këtë aspekt 23.3% e votuesve të PDK-së dhe 21% e votuesve të LDK-së, besojnë se në Kosovë duhet të ketë zgjedhje të parakohshme.

3.1. Qëndrimet mbi Subjektet e Reja Politike

Në këtë pjesë të këtij raporti do të paraqesim qëndrimet e të anketuarve mbi subjektet e reja politike të cilat potencialisht do të mund të garonin në zgjedhjet e ardhshme, kurdo që ato do të organizohen. Në këtë aspekt të anketuarit janë pyetur se: "Në rast se në zgjedhjet e ardhshme (zgjedhjet për Kuvendin e Kosovës) do të garonte një parti e re politike, a do ta votonit atë?". Rezultatet për këtë pyetje janë paraqitur në grafikun e mëposhtëm:



Figura 10. Në rast se në zgjedhjet e ardhshme (zgjedhjet për Kuvendin e Kosovës) do të garonte një parti e re politike, a do ta votonit atë?

Rezultatet tregojnë se 21.4% e të anketuarve kanë deklaruar se sikur në zgjedhjet e ardhshme të garonte një parti e re politike, ata do ta votonin. Kjo përqindje edhe mund të rritet pasi që 30.3% kanë deklaruar "nuk e di", 12% "Nuk jam i/e sigurt" kurse 2.7% kanë refuzuar të përgjigjen.

Studimi ka analizuar përgjigjet e të anketuarve të gjinive të ndryshme: femra dhe meshkuj, mbi gatishmërinë e tyre për të votuar një subjekt të ri politik në zgjedhjet e ardhshme kurse rezultatet për këtë çështje janë paraqitur në grafikun e mëposhtëm.



Figura 11. Në rast se në zgjedhjet e ardhshme (zgjedhjet për Kuvendin e Kosovës) do të garonte një parti e re politike, a do ta votonit atë? [sipas gjinisë]

Rezultatet tregojnë se ka një pajtueshmëri të njëjtë të femrave dhe meshkujve kur flitet mbi preferencat e subjekteve të reja politike. Të anketuarit e dy gjinive janë deklaruar me 21.4%, se do të votonin një parti të re në zgjedhjet e ardhshme.
Por, ajo që vërehet në rezultatin e kësaj pyetje është se përqindja e femrave të cilat kanë deklaruar se nuk do të votonin një parti të re politike në zgjedhjet e ardhshme, është me vogël (29.5%) se përqindja e meshkujve (37.5%).

Studimi ka analizuar edhe gatishmërinë e të anketuarve të moshave të ndryshme për të votuar një subjekt të ri politik në zgjedhjet e ardhshme përderisa rezultatet janë paraqitur në grafikun e mëposhtëm.



Figura 12. Në rast se në zgjedhjet e ardhshme (zgjedhjet për Kuvendin e Kosovës) do të garonte një parti e re politike, a do ta votonit atë? [sipas grup moshave]

Rezultatet tregojnë se grup moshat "56-65 vjeç" dhe "36-45 vjeç", janë më të gatshme për të votuar një parti të re politike në zgjedhjet e ardhshme përderisa grup mosha mbi 66 vjeç, rezulton të jetë grup mosha me përqindje më të ulët të gatishmërisë për të votuar një subjekt të ri politik.

Falënderime

Në këtë kontekst, Lëvizja FOL falënderon të gjithë personat që punuan në sigurimin e informacioneve dhe përpilimin e këtij raporti. Ndërsa, të gjitha Raportet e Lëvizjes FOL janë të publikuara në këtë ueb faqe: www.levizjafol.org.

Rreth Lëvizjes FOL

Organizata është themeluar të mbështes qytetarin aktive, të rris transparencën dhe llogaridhënien e institucioneve publike për të kontribuar në qeverisje të mirë dhe parandalim të korrupsionit. Për t'i përmbushur qëllimin e saj, organizata do të ndërmarrë aktivitetet si: debate dhe trajnime, konferenca, seminare dhe tryeza, publikime dhe hulumtime, avokim si dhe mbështetje teknike dhe institucionale, monitorimin e institucioneve publike si dhe mobilizim dhe rrjetëzim. Shpenzimi i fondeve publike, konflikti i interesit, neglizhenca dhe përgjegjësia institucionale si dhe qasja në informacione zyrtare, përbëjnë çështjet kryesore të punës së FOL.